



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

## RAPORTI (ME KOMENTE) PËR ECURINË E TAKIMIT PUBLIK PËR PROJEKT-KRIJIMIN E INFRASTRUKTURËS TURISTIKE NEREDIME E POSHTME

"Ky raport është hartuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr. 04/2023 për Administratën e Hapur."

Publikimet:

Me 12.05.2026

Në uebfaqe:

<https://ferizaj.rks-gov.net/takimet-publike/?tax=njoftime>

Me 20.05.2026, është mbajtur takimi publik, vegëza e lajmi për mbajtjen e konsultimit:

<https://ferizaj.rks-gov.net/neës/ferizaj-synon-zhvillimin-e-turizmit-ne-neredime-te-poshtme-mbahet-takim-publik-me-qytetaret/>

Banorët e fshatit Neredime e Poshtme janë njoftuar paraprakisht me të gjithë procedurat e aplikimit në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, që do ta bëjë Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në Ferizaj.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT

KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA

MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002

E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)

Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Me 21.05.2026, është publikuar procesverbali për mbajtjen e takimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

<https://ferizaj.rks-gov.net/takimet-publike/?tax=procesverbale-takime-publike>

Përmes formës elektronike, në adresat e e-mailit të zyrtarëve përgjegjës për pranimin e komenteve, nuk është pranuar asnjë koment nga qytetarët. Komente nuk janë pranuar as në ndonjë formë tjetër elektronike.

Takimi i fundit i grupit punues është mbajtur më 25.05.2026, ku është diskutuar për pranimin e komenteve si në formë elektronike, gjatë konsultimeve, ashtu edhe në formë fizike.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

Tabelori me të dhëna të shkurtra:

| Metodat e konsultimit                                                                                                | Data / Kohëzgjatja          | Numri i pjesëmarrësve                       | Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime      | Numri i kërkesave të pranuar |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|---------------------------------------------|---------------------------------------------------------------|------------------------------|
| 1- Takim publik i drejtpërdrejt me qytetarë Projekt-Krijimin infrastrukturës turistike në fshatin Neredime e Poshtme | 20.05.2026                  | F M T<br>1 17 18                            | 0                                                             | 0                            |
| Është mbajtur 1 takim publik                                                                                         | 1 orë ka zgjatur konsultimi | Totali i pjesëmarrësve:<br>F M T<br>1 17 18 | Totali i qytetarëve që kanë dhënë komente, kërkesa/sugjerime: | Totali i kërkesave:<br>10    |

Shtojca-Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

| Nr | Kërkesat /Sugjerimet / Komentet                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim në takimin publik për krijimin e zonës turistike në N | Statusi i kërkesës /sugjerimi pranuar pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar | Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. | <p>A ka mundësi që në kuadër të projektit të parashihet ndërtimi i fushave multifunksionale për aktivitete sportive si futboll, basketboll, volejboll dhe tenisi etj.</p> <p>Poashtu a keni paraprë edhe ndriçimin publik me energji solare, me qëllim të uljes së kostove financiare dhe mirëmbajtjes nga ana e Komunës së Ferizajt.</p> | Artan Azizi                                                                            | E aprovuar                                                                       | <p>Në kuadër të projektit është paraparë ndërtimi i hapësirave sportive të cilat do të krijojnë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme sportive dhe rekreative për qytetarët.</p> <p>Sa i përket ndriçimit publik me energji solare, kjo çështje do të trajtohet gjatë fazave të detajimit teknik të projektit, duke u vlerësuar mundësitë për aplikimin e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe energjetikisht efikase, në funksion të uljes së kostove operative dhe të mirëmbajtjes për Komunën e Ferizajt.Sugjerimet dhe kontributet e qytetarëve mbeten të rëndësishme dhe do të merren</p> |



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

|    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |               |                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|--------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |               |                          | parasysh gjatë zhvillimit të mëtejme të projektit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| 2. | <p>Nese ka mundësi qe gjate projektit te behen edhe ujësjellësi ne menyre qe te kemi kujdes per pjesën e gjelbëruar?</p> <p>Propozoj që të realizohen edhe diktutime me biologë dhe ekologë, me qëllim të përcaktimit të saktë të llojeve të drunjve dhe kulturave që duhet të mbillen, duke siguruar kështu jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre.</p> | Ekrem Bajrami | E Aprovuar<br>Pjesërisht | <p>Në kuadër të projektit është paraparë instalimi i një sistemi të ujitjes për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sipërfaqeve të gjelbëruara, me qëllim të sigurimit të kushteve të përshtatshme për rritjen dhe qëndrueshmërinë e vegjetacionit.</p> <p>Sa i përket propozimit për përfshirjen e biologëve dhe ekologëve në përcaktimin e llojeve të drunjve dhe kulturave që do të mbillen, ju informojmë se një angazhim i tillë nuk është paraparë në kuadër të këtij projekti. Megjithatë, sugjerimi juaj është i vlefshëm dhe do të evidentohet për shqyrtim në iniciativat dhe projektet e ardhshme.</p> |
| 3. | <p>Kërkojë nga ana juaj që ulëset të jenë të hapur dhe të mbyllura.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Alban Krosa   | E aprovuar<br>pjesërisht | <p>Projekti parasheh vendosjen e ulëseve të hapura për përdoruesit e hapësirës publike. Bazuar në konceptin dhe zgjidhjen e projektuar, nuk është</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

|  |  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                      |
|--|--|--|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  |  |  |  | <p>paraparë inkorporimi i ulëseve të mbyllura në këtë fazë të realizimit të projektit.</p> <p>Megjithatë, vlerësojmë interesimin dhe kontributin tuaj, ndërsa sugjerimi i paraqitur do të evidentohet si pjesë e procesit të konsultimit publik.</p> |
|--|--|--|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Shkurtesat:

F-Femra

M-Meshkuj

T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Njoftimin për mbajtjen e takimi publik,
2. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në takimi publik,

Raporti është përgatitur nga:

Shyhrete Topalli

Udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun